

VENDIM
Nr.730, datë 7.11.2007

**PËR DHËNIEN NË PËRDORIM AGJENCISË KOMBËTARE TË SHOQËRISË SË
INFORMACIONIT, MINISTRISË SË INTEGRIMIT, AVOKATIT TË PROKURIMEVE
PUBLIKE, QENDRËS KOMBËTARE TË REGJISTRIMIT DHE AGJENCISË SË
PROKURIMEVE PUBLIKE TË DISA MJEDISEVE TË NDËRTESES (GODINËS) SË ISH-
INIMA-S**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10 e 13 të ligjit nr.8743, datë 23.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Dhënien në përdorim Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit të disa mjediseve, në katin përdhe të ndërtesës së ish-INIMA-s, në administrim të Këshillit të Ministrave, sipas vendndodhjes së përcaktuar në planimetrinë, në shtojcën 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Qendra Kombëtare e Regjistrimit dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit do të shfrytëzojnë hapësirat e përbashkëta, sipas planimetrisë, bashkëlidhur vendimit.

2.Dhënien në përdorim Ministrisë së Integrimit të disa mjediseve, në katin përdhe, të ndërtesës së ish-INIMA-s, në administrim të Këshillit të Ministrave, sipas vendndodhjes së përcaktuar në planimetrinë, në shtojcën 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.


3. Dhënien në përdorim Ministrisë së Integrimit, Avokatit të Prokurimeve Publike, Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, Agjencisë së Prokurimeve Publike dhe Agjencisë së Shoqërisë së Informacionit të hapësirave të nevojshme për parkim, sipas vendndodhjes së përcaktuar në planimetrinë, në shtojcën 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4.Ngarkohen Kryeministria, Ministria e Integrimit, Avokati i Prokurimeve Publike, Qendra Kombëtare e Regjistrimit dhe Agjencia e Prokurimeve Publike për zbatimin e këtij vendimi,

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Godina e ish-Ordinatorit Qendror - Kati per dhe Sh 1:200



Siperfaqe e QKR


siperfaqe e Ministrise se Integritit

Siperfaqe e AKSH

Siperfaqe e perbashket

Sh 1:200

Godina e ish-Ordinatorit Qendror -Garazhet



Ministria e Integritetit
Qendra Kombete e
Regjistrimit
Agjensia e Prokurimeve
Publike
Agjensia Kombete e
Shërbimeve të Informacionit
Agjensia e Prokurimeve
Publike